



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 28.03.2023)*

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

1.1 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;

1.2 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”;

1.3 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;

1.4 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër;

1.5 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;

1.6 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;

1.7 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;

1.8 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;

1.9 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 15:15.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i>        |
| <i>2. Ilir Rusi</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>4. Irena Plaku</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>6. Ridvan Hado</i>     | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Alban Toro</i>      | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>8. Marçela Shehu</i>   | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>10. Yllka Rupa</i>     | <i>(anëtare)</i>         |

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte (EWMI-INL).*

*6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*

*7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

*8. Të tjerë: Birn.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

1.1 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;

1.2 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”;

1.3 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;

1.4 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;

1.5 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;

1.6 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;

1.7 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;

1.8 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;

1.9 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

*Naureda Llagami: Përsëritje!*

Po fillojmë mbledhjen e radhës të datës 28 mars.

Siç jeni në dijëni, në mbledhjen e sotshme kemi për shqyrtim 6 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja juaj.

Atëherë, le të fillojmë me çështjen e parë e cila është një nga çështjet më të rëndësishme që Këshilli po merret në këtë periudhë dhe që ka të bëjë me zbatimin e hartës gjyqësore. Kemi përfunduar me sukses zbatimin e hartës gjyqësore në fazën e parë për pjesën e apeleve. Tashmë jemi në fazën e dytë, që ka të bëjë me ristrukturimin e të gjithë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, dhe në zbatim të kësaj vijne edhe aktet e propozuara Këshillit, ku akti i parë është akti që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër dhe Tiranë.

Pa humbur kohë dëshiroj që t'ia jap fjalën kryetarit të grupit të punës për zbatimin e hartës gjyqësore, që është Zëvendëskryetari z. Ilir Rusi.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit Kryetare!

Është me vend për të falënderuar për të gjithë kontribuuesit në lidhje me hartimin e këtyre akteve deri në këtë moment dhe në vijim, pavarësisht nëse janë apo nuk janë pjesëtarë të grupit të hartës. Të gjithë se bashku kemi kontributet përkatëse në këtë proces.

Në lidhje me relacionin, detyrimi ligjor për nxjerrjen e aktit:

Nga shkurti i vitit 2019, KLGJ-ja është angazhuar në një proces gjithëpërfshirës të vlerësimit të organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, në zbatim të neneve 13 dhe 15 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces evidentoi problematika në drejtim të: shpërndarjes së pabarabartë të ngarkesës midis gjyqtarëve, volumit të çështjeve të prapambetura të krijuar, moshës së shqyrtimit të çështjeve me diferenca të konsiderueshme në 6 gjykatat aktuale të apeleve, prurjeve të çështjeve të reja në gjykatat e apeleve dhe numrit efektiv të gjyqtarëve në detyrë, për të cilët palëvizshmëria ishte kthyer në përjashtim, e lëvizshmëria për të gjykuar nga një gjykatë në tjetrën, përbënte tashmë një rregull të diktuar nga nevojat. Gjetjet e mësipërme, të shoqëruara me një

analizë të hollësishme të të dhënave statistikore, të kryer nga ekspertë ndërkombëtarë, konfirmuan se harta gjyqësore në fuqi nuk i përmbushte kërkesat ligjore, jo vetëm për gjykatat e shkallës së parë, por edhe për gjykatat e apeleve.

Pas një procesi bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë e më gjerë, si dhe pas konsultimit me grupet e interesit, propozimi i përbashkët i KLGJ dhe MD “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave të gjykatave” u miratua me vendimin nr. 495, datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave, i botuar në fletoren zyrtare nr. 107, datë 21.07.2022. Ky propozim parashikon, midis të tjerash, riorganizimin e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në 13 gjykata të rretheve gjyqësore.

Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër dhe Tiranë të cilat fillojnë funksionimin në datën 1 maj 2023, ushtrojnë funksionin e tyre në selitë dhe kompetencat tokësore të mëposhtme:

a) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, me seli në qytetin e Peshkopisë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos;

b) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me seli në qytetin e Durrësit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Durrës, Shijak, Kavajë dhe Rrogozhinë;

c) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me seli në qytetin e Fierit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Lushnjë, Divjakë dhe Mallakastër;

ç) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, me seli në qytetin e Gjirokastrës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë dhe Dropull;

d) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me seli në qytetin e Lezhës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin;

dh) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me seli në qytetin e Korçës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë,

Devoll dhe Pogradec;

e) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me seli në qytetin e Kukësit dhe kompetencë tokësore në bashkitë Kukës, Has dhe Tropojë;

ë) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me seli në qytetin e Shkodrës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë-Arrëz;

f) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Tiranë, Kamzë, Vorë dhe Krujë.

Për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj VKM-je, me urdhrin nr.80, datë 27.07.2022 të Kryetares së KLGJ është ngritur dhe po funksionon një Grup Ndërinstitucional Pune, i cili ka në përbërje përfaqësues të KLGJ-së (anëtarë dhe drejtues të lartë të administratës), gjyqtarë të gjykatave të apeleve dhe kancelarë, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe të projekteve të mbështetjes teknike që e kanë shoqëruar KLGJ-në. Detyra e këtij grupi pune është ndërtimi i një plani të detajuar e funksional të zbatimit të hartës së re gjyqësore, me shtylla kryesore të punës: burimet njerëzore, administrimi gjyqësor, administrata gjyqësore, godinat dhe infrastruktura, teknologjia e informacionit, administrimi i çështjeve, përgjegjësitë buxhetore e detyrimet financiare si dhe jo më pak i rëndësishëm, informimi i publikut.

Ky plan i detajuar pune i miratuar nga vetë grupi i punës, kërkon angazhimin e Mbledhjes Plenare për miratimin e akteve nënligjore, me karakter normativ apo kolektiv sipas rastit, si dhe kryerjen e një sërë veprimesh nga administrata e Këshillit në bashkëpunim me gjykatat, me qëllim sigurimin e funksionimit normal të punës në datën 1 maj 2023 në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër dhe Tiranë.

Projekt-aktet “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë”, “Për fillimin e

funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër” dhe “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” i paraqiten për miratim Mbledhjes Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të detyrimeve kushtetuese e ligjore të këtij Këshilli, për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, veçanërisht në drejtim të ofrimit të shërbimeve cilësore dhe në kohë nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të cilat do t’i nënshtrohen procesit të riorganizimit të kompetencave tokësore.

Në lidhje me natyra e aktit dhe harmonizimi i tij me kuadrin ligjor ekzistues:

Aktet që i paraqiten për miratim Këshillit janë akte normative nënligjore, të cilat janë të harmonizuara me misionin, vizionin dhe vlerat thelbësore të pushtetit gjyqësor, si dhe Objektivin Strategjik 3 të Planit Strategjik të KLGJ 2022-2024, që synon përmirësimin e ofrimit të shërbimeve efikase përmes miratimit dhe zbatimit të hartës së re gjyqësore, novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë që garantojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë e gjykatave.

Projektvendimet janë konceptuar si vendime kuadër, që përcaktojnë tërësinë e parimeve që do të udhëheqin procesin e zbatimit të riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë duke synuar vijimësinë në drejtimin dhe ofrimin e shërbimeve gjyqësore, administrative dhe atyre mbështetëse nga këto gjykata, në datën 1 maj 2023.

Parimi kryesor mbi të cilin bazohet përmbajtja e projekt-akteve është ai i “gjykatave të riorganizuara” dhe jo ai i krijimit të një “gjykate të re”. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, gjykatat krijohen vetëm me ligj. Vendimi i Këshillit të Ministrave në rastin konkret riorganizon kompetencat tokësore të gjykatave në mënyrë të tillë që kompetencat aktuale tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore

Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë zgjerohen duke përfshirë kompetencat tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë sipas kompetencave tokësore të lartpërmendura. Nëntë gjykatat e rretheve, pushojnë së funksionuari pas datës 1 maj 2023, kompetencat tokësore të cilave janë përthithur nga Gjykatat e shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë.

Riorganizimi i kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë përkatësisht nën Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë, passjell mbarimin e ekzistencës si persona juridikë të nëntë gjykatave të rretheve gjyqësore. Fillimi i funksionimit të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë kërkon vendimmarrjen e Këshillit në shumë drejtime si: sistemimi në pozicione të gjyqtarëve të gjykatave të rretheve gjyqësore që riorganizohen, i punonjësve që ofrojnë shërbime administrative e mbështetëse në këto gjykata, transferimi i çështjeve e dosjeve gjyqësore, funksionimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe regjistrimit audio i seancave gjyqësore, infrastruktura e teknologjisë së informacionit dhe ajo fizike e godinave, komunikimi me publikun dhe përdoruesit e gjykatave.

Të gjitha dispozitat e projektvendimeve janë hartuar në frymën dhe përçojnë të njëjtin parim, atë të “gjykatës së riorganizuar”, e cila vijon rregullisht ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore e administrative:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër emërtohet “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër” dhe fillon funksionimin më datë 01.05.2023.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës emërtohet “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës” dhe fillon funksionimin më datë 01.05.2023.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier emërtohet “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier” dhe fillon funksionimin më datë 01.05.2023.



Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë emërtohet “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë” dhe fillon funksionimin më datë 01.05.2023.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë emërtohet “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë” dhe fillon funksionimin më datë 01.05.2023.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë emërtohet “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë” dhe fillon funksionimin më datë 01.05.2023.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës emërtohet “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës” dhe fillon funksionimin më datë 01.05.2023.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër emërtohet “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër” dhe fillon funksionimin më datë 01.05.2023.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë emërtohet “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” dhe fillon funksionimin më datë 01.05.2023.

Parimet bazë mbi të cilat janë hartuar projekt-aktet përfshijnë garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit qytetarëve dhe përdoruesve të gjykatës në gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm plotësisht funksionale në datën 1 maj 2023, parimin e efikasitetit në trajtimin e procesit të riorganizimit, mbajtjen në konsideratë të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale të gjykatave, përmbylljen e procesit të riorganizimit brenda afatit të caktuar dhe me transparencë.

Për sa i përket përputhshmërisë së aktit me standardet ndërkombëtare:

Projektvendimet janë hartuar duke marrë në konsideratë standardet më të mira ndërkombëtare të cilat kanë udhëhequr procesin e vlerësimit dhe përgatitjes së hartës së re gjyqësore, që synojnë të garantojnë vijimësinë në ofrimin e shërbimeve, specializimin, racionalizimin e shpenzimeve publike.

Më konkretisht kanë qenë opinionet, rekomandimet dhe studimet e CEPEJ-it që ofrojnë ekuilibër midis parimeve ndërkombëtare të mirëpranuara si: a) aksesin në drejtësi; b) efikasitetin dhe eficienten e sistemit gjyqësor dhe c) cilësinë e shërbimeve gjyqësore.

Në lidhje me konsultimin e aktit:

Projektvendimet janë një produkt i dakordësuar në mbledhje nga të gjithë anëtarët e grupit të punës, përfaqësues të të gjitha institucioneve brenda e jashtë sistemit gjyqësor

që ndikohen nga zbatimi i hartës së re gjyqësore. Në këtë relacion shpjegues parashtrohen dhe argumentohen zgjidhjet e propozuara, mbi parimet mbështetëse të sipërpërmendura për zbatimin efektiv të hartës së re gjyqësore.

Në lidhje me komentet e përgjithshme mbi aktin:

Aktet e propozuara për miratim reflektojnë tërësinë e masave që duhen marrë paraprakisht me qëllim që konfigurimi i ri i propozuar të garantojë vazhdimësinë dhe funksionalitetin e pandërprerë të shërbimeve në gjykatë. Në të njëjtën kohë aktet i shërbejnë përmbushjes së nevojës për rritjen e efikasitetit të shërbimeve gjyqësore dhe shpërndarjes në mënyrë proporcionale të ngarkesës së punës midis të gjithë gjyqtarëve në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Konceptimi i akteve si vendime kuadër synon pasjen e vendimeve që orientojnë qartë dhe shërbejnë si udhërrëfyes për hapat e tjera të punës për riorganizimin e gjykatave sipas fazave të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave. Në të njëjtën kohë, pas miratimit këto vendime, i hapin rrugë miratimit të akteve të tjera të nevojshme që do të bëjnë të mundur vijimin e funksionalitetit të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë, sistemimin e administratës gjyqësore të Gjykatave të Rrethave Gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë përmes ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit, apo miratimit të rregullave standarde dhe organikës së gjykatës, miratimit të rregullave të administrimit të çështjeve gjyqësore, etj. Veçanërisht për çështje që lidhen me Teknologjinë e Informacionit, vendimi kuadër përcakton shprehimisht përgjegjësinë e Drejtorisë së Administrimit Gjyqësor dhe të Teknologjisë së Informacionit për të ndjekur me prioritet procesin e harmonizimit të kërkesave ligjore e procedurale me elementët teknike të sistemeve të menaxhimit të çështjeve gjyqësore me qëllim garantimin e funksionalitetit të plotë të tyre.

Për sa i përket shpjegimit të detajuar të përmbajtjes së aktit:

Vendimet kuadër janë ndarë në 6 seksione dhe 8 nene në tërësi.

Seksioni I dhe neni 1 parashikojnë emërtimin dhe selinë e Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë,

Kukës, Shkodër e Tiranë, datën e fillimit të funksionimit në 1.05.2023, si dhe afatin kohor fundor kur Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë ndërpresin veprimtarinë e tyre, duke parashikuar datën 30.04.2023. Kjo e fundit përbën edhe datën e pushimit së ekzistuari si persona juridikë të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë. Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë, si persona juridikë, përbëjnë “gjykatën mëmë” kompetencat tokësorë të së cilës tashmë përfshijnë kompetencat tokësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ndryshon emërtimin e saj nga “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër” në “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndryshon emërtimin e saj nga “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës,” në “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ndryshon emërtimin e saj nga “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier,” në “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ndryshon emërtimin e saj nga “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë,” në “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ndryshon emërtimin e saj nga “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë,” në “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ndryshon emërtimin e saj nga “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë,” në “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, ndryshon emërtimin e saj nga “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës,” në “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndryshon emërtimin e saj nga “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër,” në “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshon emërtimin e saj nga “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,” në “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Parimi i “Riorganizimit të kompetencave tokësore por jo krijimit të gjykatës së re, pasqyrohet në këtë nen, duke bërë dallimin midis procesit të riorganizimit të ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore nga 18 (tetëmbëdhjetë) gjykata rrethesh gjyqësore në 9 (nëntë) gjykatë të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, nga ai i bashkimit të 9 (nëntë) gjykatave si persona juridikë (gjykata bija) me 9 (nëntë) gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm (gjykatë mëmë), nën një emërtim të ri. Në kuadër të vijimit të ushtrimit të veprimtarisë, vlen të theksohet që Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë, veç ndryshimit të emërtimit të tyre, nuk është e nevojshme të pajisen me numër unik tjetër identifikimi, sepse nuk përbëjnë persona juridikë të rinj, por të riorganizuar nga bashkimi me to, i 9 personave juridikë, përkatësisht gjykatat “bija” të rretheve gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë.

Bazuar në parimet e këtij neni, 9 personat juridikë, gjykatat “bija” të rretheve gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë, me mbarimin e tyre në datën 30.04.2023, humbasin personalitetin e tyre juridik. E njëjta gjë nuk vlen për Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë, të cilat vijojnë të gëzojnë të njëjtin personalitet juridik, edhe pas bashkimit, duke u ndryshuar vetëm emërtimi.

Seksioni II dhe neni 2 trajtojnë çështje që lidhen me organizimin dhe funksionimin e Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë. Konkretisht në lidhje me gjyqtarët e këtyre gjykatave, vendimet nuk kanë përcaktuar numër konkret, duke parashikuar nevojën e nxjerrjes së një akti të veçantë të KLGJ-së, me qëllim që në

eventualitetin e ndryshimit të këtij numri në të ardhmen, të mos jetë e nevojshme ndryshimi i përmbajtjes së vendimeve kuadër.

Parashikimet e këtij neni janë reflektim i parimeve kushtetuese të palëvizshmërisë dhe vijimësisë në ushtrimin e detyrës së gjyqtarëve të cilët janë të emëruar apo caktuar në pozicione të përhershme në gjykatat e rretheve gjyqësore, sipas parashikimeve të neneve 42 pika 3 shkronja “b” dhe neni 44 pika 1 shkronja “a” të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Për gjyqtarët e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë, vendimet parashikojnë qëndrimin në pozicione të përhershme në strukturën e Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë. Vijimësia në ushtrimin e funksionit për gjyqtarët e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë, të cilëve u suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit, sigurohet përmes transferimit të tyre në strukturën e Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë.

Nevoja e plotësimit të vendeve vakante mbetet evidente, prandaj për të siguruar këtë të fundit si dhe sigurinë juridike për gjyqtarët që tashmë kanë aplikuar për këto pozicione, vendimet kuadër “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës” dhe “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” shprehin edhe njëherë angazhimin e KLGJ-së për të vijuar procedurat aktuale për lëvizje paralele e transferime të përkohshme të shpallura në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Tiranë, për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës e Tiranë. Kështu vendimet për “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës” dhe “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” parashikojnë se pozicionet e shpallura për lëvizje paralele e transferime të përkohshme në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Durrës e Tiranë, për të cilat procedura nuk ka përfunduar ende në datën 01.05.2023, konsiderohen

pozicione të lira të përhershme/përkohshme (sipas rastit) përkatësisht të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke garantuar vijimin e procedurave për lëvizje paralele e transferime të përkohshme të shpallura më parë nga Këshilli në këto gjykata.

Seksioni 3 dhe neni 3, trajtojnë çështje që lidhen me organet e administrimit gjyqësor. Vendimet konfirmojnë edhe njëherë parime të parashikuara nga ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Kështu në mungesë të kryetarit të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë, kompetencat ushtrohen nga zëvendëskryetari i gjykatës deri në zgjedhjen e kryetarit, sipas ligjit.

Vendimet synojnë të sigurojnë një qasje të kombinuar duke garantuar jo vetëm vijimësinë në ushtrimin e detyrës sipas mandatit, por edhe përfaqësimin për aq sa është e mundur të trupës gjyqësore në Këshillin e Gjykatës. Kështu në vijim të parimeve të mësipërme, vendimet parashikojnë se Zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë, qëndron në detyrën e zëvendëskryetarit të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë deri në përfundim të mandatit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, sipas ligjit.

Vijimësia parashikohet edhe për kancelarët në detyrë që ushtrojnë funksionet në gjykatat e Rretheve Gjyqësore Durrës, Fier, Lezhë, Korçë, Gjirokastrë dhe Tiranë, të cilët qëndrojnë në detyrën e kancelarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Lezhë, Korçë, Gjirokastrë dhe Tiranë deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate, sipas ligjit (neni 83 i Ligjit 98/2016).

Për gjykatat e rretheve gjyqësore Dibër, Shkodër dhe Kukës në të cilat nuk ushtrojnë funksione kancelarë në detyrë, Këshilli i Lartë Gjyqësor me propozim të Komisionit të Ristrukturimit cakton kancelarin në detyrë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Shkodër dhe Kukës.

Ndërsa kancelarët në detyrë të gjykatave të tjera të rretheve gjyqësore, duke qenë pjesë e administratës gjyqësore të gjykatave që mbarojnë funksionin, do t'i nënshtrohen procesit të ristrukturimit, për shkak të suprimimit të pozicionit, sipas parashikimeve të mëposhtme në projekt-akte.

Këshilli i Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastër, Lezhë, Korçë, Kukës e Shkodër, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, përbëhet nga zëvendëskryetari, kancelari në detyrë dhe gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar në datën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastër, Lezhë, Korçë, Kukës e Shkodër, sipas parashikimeve të Vendimit të KLGJ-së nr. 71, datë 20.05.2019 “Për procedurën e funksionimit të Këshillit të Gjykatës”.

Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit, nuk ndryshon përbërjen aktuale të tij, sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 71, datë 20.05.2019 “Për procedurën e funksionimit të Këshillit të Gjykatës”, për gjyqtarin e dytë në listë në garën për zëvendëskryetar, si e vetmja gjykatë me këtë përbërje në garë.

Seksioni IV, neni 4 vendos rregulla për administrimin e brendshëm gjyqësor, duke synuar vijimin e ofrimit të shërbimeve gjyqësore, administrative dhe mbështetëse.

Neni 4 merr në konsideratë parashikimet ligjore të nenit 66, pika 6 e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” duke evidentuar nevojën për miratimin e disa akteve të veçanta që detajojnë respektivisht rregullat për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit dhe rregullat standarde për strukturën dhe organikën e administratës gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Duke synuar garantimin e funksionalitetit, në mungesë të krijimit të një gjykate të re, mbështetur në parimet e mësipërme, në nenin 4 të projekt-akteve është parashikuar se administrata gjyqësore e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastër, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë, e përbërë nga punonjësit e konfirmuar tashmë në detyrë nga Këshilli i Gjykatës, që ushtrojnë shërbimet gjyqësore,

administrative dhe ato mbështetëse sipas përcaktimeve në ligjin 98/2016, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë dhe nuk i nënshtrohen procesit të ristrukturimit. Ndërsa administrata gjyqësore e personave juridikë që mbarojnë për shkak të ndërprerjes së ushtrimit të funksionit, në gjykatat e tjera të rretheve gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë, i nënshtrohet procesit të ristrukturimit, pasi pozicionet e tyre suprimohen.

Procesi i ristrukturimit i hap rrugë sistemimit të të gjithë punonjësve të gjykatave të rretheve gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë, në pozicionet e strukturës së Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë, ose në gjykatat e tjera në rast se do të jetë e nevojshme. Grupi i punës është udhëhequr nga parimi i cituar që në momentin e përgatitjes së projektit për hartën e re gjyqësore, për sistemimin në pozicione në gjykata, të të gjithë personelit të gjykatave të rretheve gjyqësore që si persona juridikë i bashkohen nën një emërtim të ri gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë. Krijimi dhe funksionimi i Komisionit të Ristrukturimit do të miratohet me një akt të veçantë të Këshillit, mbi bazën e parimeve të përcaktuara pikërisht në nenin 4 të projekt-akteve. Drafti përkatës është duke u përfunduar nga grupi i punës, sikundër edhe rregullat e brendshme të gjykatave që përcaktojnë rregulla standarde për strukturën, përshkrimet e punës dhe organikën e Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë.

Seksioni V, nenet 5 dhe 6 përcaktojnë parimet e transferimit dhe menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Konkretisht neni 5 parashikon se të gjitha çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Kukës, Kurbin, Krujë, Lezhë, Lushnjë, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë e Tropojë deri në datën 30.04.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen si çështje të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm



Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve. Vendimet ngarkojnë shprehimisht Departamentin e Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit për të ndjekur procesin e transferimit dhe regjistrimit të tyre manualisht apo elektronikisht. Ky parashikim nuk është shmangie nga parimi i mësipërm i “gjykatës së riorganizuar dhe gjykatës së re”, përkundrazi mundëson një nga qëllimet e hartës së re gjyqësore për evidentimin dhe regjistrimin e të gjitha çështjeve të regjistruara në gjykatat e rretheve gjyqësore sipas moshës e kategorisë, si çështje tashmë të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë.

Në lidhje me menaxhimin e çështjeve gjyqësore të transferuara në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë, vendimet parashikojnë se ato nuk rindahen me short elektronik. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

Seksioni VI neni 7, parashikon parimin e marrjes së përgjegjësiwe buxhetore dhe financiare nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër e Tiranë për shkak të mbarimit si persona juridikë të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë.

Neni 8 parashikon rregullin e hyrjes në fuqi nisur nga natyra e aktit si akt normativ nënligjor.

Në lidhje me zbatimin e aktit:

Zbatimi i akteve kuadër kërkon qasje proaktive nga të gjitha gjykatat, si organet drejtuese ashtu edhe administrata gjyqësore, për të bashkëpunuar ngushtësisht me KLGJ-në e për të siguruar vijimësi në ofrimin e shërbimeve, drejtësi efektive dhe në kohë për qytetarët.

Për sa i përket efekteve financiare të aktit:

Aktet nuk krijojnë drejtpërdrejt efekte të tjera financiare për hartën e re gjyqësore, veç atyre të parashikuara më parë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Ky ishte relacioni për sa i përket projektvendimeve në lidhje me fillimin e funksionimit të Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër; Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”; Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier; Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë; Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë; Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë; Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës; Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Gjithashtu pjesë e kësaj pike të rendit të ditës është edhe relacioni përkatës në lidhje me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për sa i përket: Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat; Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”; Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë; Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

*(Merr fjalën zonja Ukperaj!)*

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit zonja Kryetare!

Atëherë, në momentin që janë përpiluar këto projekt-akte për mbledhje plenare nuk ishin mbaruar ende procedurat e transferimit të përkohshëm. Për këtë arsye, në pikën 4 të projektvendimit për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Tiranë u parashikua që pozicionet e shpallura për lëvizje paralele e transferime të përkohshme, të cilat nuk ishin përfunduar, do të

konsideroheshin për efekt të kësaj. Në kushtet kur transferimet tashmë kanë përfunduar, unë do të sugjeroja që në pikën 4 (neni 2) “transferime të përkohshme” të hiqej dhe në pikën 2 (neni 2), duke qenë se ne kemi në Durrës dhe në Tiranë gjyqtarë të caktuar në mënyrë të përkohshme, të shtohet duke u formuluar “gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm/të përkohshëm” sepse kemi edhe gjyqtarë të përhershëm dhe të përkohshëm. Ata do vazhdojnë të qëndrojnë në pozicione të lira të përhershme ose të përkohshme të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. I njëjti parashikim edhe për Tiranën. Pra tek pika 2 “Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm/përkohshëm”, propozoj që të shtohet, dhe njëkohësisht tek pika 4, të hiqet “transferimet e përkohshme” (pjesa e “transferimeve të përkohshme dhe pjesa e “pozicioneve të lira të përkohshme”). Për Durrësin dhe për Tiranën, për ta përputhur me gjendjen aktuale ku ne nuk kemi më pozicione të lira të përkohshme që i kemi në procedurë.

Një propozim tjetër për Tiranën, tek neni 3, pika 5. Në relacion shpjegohet shumë mirë qëllimi i këtij parashikimi ndryshe nga parashikimet e gjykatave të tjera, konsiston në faktin që Këshilli i Gjykatës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk do ta ndryshojë përbërjen, sepse ndryshe nga gjykatat e tjera ka pasur gjyqtarë të dytë në listë. Fjala “aktuale”, në vlerësimin tim, duhet të hiqet për arsye sepse e ngatërron me përbërjen aktuale që ka Këshilli i Gjykatës. Duke qenë se gjyqtarja e dytë në listë, zonja Goxha është me leje barrë lindjeje, përbërja aktuale e Këshillit të Gjykatës në fakt është nga zëvendëskryetari, nga kancelari dhe nga gjyqtari me përvojën më të lartë profesionale. Nëse ne heqim “aktuale”...

Nuk e di, ne e zëvendësuam në mentorim dhe duke pasur këtë informacion, ajo “aktuale” duhet të hiqet.

**Marçela Shehu:** Faktikisht Këshilli i Gjykatës së Tiranës ka funksionuar me anëtarin tjetër, në vend të zonjës {...}. Kështu që situata aktuale faktikisht është ndryshe, nuk është me zonjën {...}.

**Brikena Ukperaj:** Nuk ndryshon përbërjen e tij. Ajo do kthehet dhe do shkojë prapë në pozicion.

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Brikena Ukperaj:** Përbërja aktuale është znj. {...}.

**Marçela Shehu:** Ta zgjidhi vetë gjykata.

Situata aktuale është kjo. Këtë situatë dimë.

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Brikena Ukperaj:** Nuk ka funksionuar, sepse apeli i Tiranës nuk kishte gjyqtarë të dytë në listë në zgjedhjen e zëvendëskryetarit. Ishte vetëm një person.

Unë shpreh që “aktuale” mund të mos qëndrojë.

Duke i thënë që je ti sot, atëherë nuk mund të vazhdosh me këtë përbërje aktuale, sepse i zhvesh mandatin.

Ok, – në qoftë se ju e lexoni ndryshe...

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Brikena Ukperaj:** Një sekondë. Shiko si është formulimi.

“Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe emërimin e kancelarit...”, pra ti i jep fuqi kësaj përbërjeje aktuale deri në momentin që do zgjidhet kryetari dhe emërohet kancelari. Kështu që “aktuale” duhet të hiqet. Nuk ndryshon përbërjen e tij. Se cila është përbërja, kjo është rast pas rasti.

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Marçela Shehu:** Kemi dashur t'i vëmë theksin vazhdimësisë së organit të Këshillit të Gjykatës, pra është i njëjti këshill. Se cili është Këshilli, me cilën përbërje, le ta vendosi vetë.

**Brikena Ukperaj:** Naureda më fal, se aktet vijnë nga Komisioni.

Në akt është thënë që zëvendëskryetari qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e zëvendëskryetarit të ri. Është sqaruar edhe kjo situatë. Këshilli i gjykatës është parashikim më vete për këshillin e gjykatës. Për ta sqaruar, unë mendova që të hiqet “aktuale”. Në qoftë se ju mendoni që del qartë, nuk ka nevojë. Ok, mos e heqim.

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Marçela Shehu:** Tani, të shkëputemi nga emrat. Qëllimi ka qenë, që ne të ruajmë vazhdimësinë e organit, si për zëvendëskryetarin, ashtu edhe për Këshillin e Gjykatës.

**Brikena Ukperaj:** Në fakt Ilir, nuk është term ligjor “përbërja aktuale”. Është “përbërja e Këshillit”. Aktualiteti lidhet me mungesat në detyrë të zëvendëskryetarit apo kryetarit, se mund të ndodhë që edhe zëvendëskryetari nuk ndodhet në detyrë. Pra termi ligjor është “përbërja e Këshillit”, nuk lidhet me “përbërja aktuale”. Prandaj thashë termin “aktuale” për ta hequr.

**Alban Toro:** Kam unë dy propozime të vogla.

Problemin e parë e kam me nenin 6 të cilin unë e interpretoj.. pra neni 6 është tek menaxhimi i çështjeve gjyqësore që prek të gjithë gjykatat. “Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë (po marrë Dibrën se është në linjë e para), nuk i nënshtrohen ndarjes së çështjeve me short. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.”

Që do të thotë, si e kuptoj unë, besoj edhe shumica kështu e kupton. Secili mban dosjet e veta, gjykimet e veta. Thelbi është më pas, kur fillojnë vijnë çështjet e reja që

nuk janë në gjykim. Teknikisht këto duhet të ndahen midis dy trupave gjykues, atyre të Dibrës, të shpërndahen në mënyrë të barabartë. Sepse ky është thelbi i bashkimit, apo jo? Që secili gjyqtar të ketë një ngarkesë të barabartë me çdo koleg të vetin. Kështu që, për këtë unë bëra këtë riformulim, në qoftë se jeni dakord, ta aplikojmë: “Çështjet gjyqësore në gjykim, të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues. (Shtesa) Të gjithë çështjet e tjera në këtë gjykatë, rishortohen në mënyrë të barabartë me të gjithë numrin e gjyqtarëve”. Pra çdo çështje e re që vjen do rishortohet në short në mënyrë të barabartë midis të gjithë gjyqtarëve. Vijnë 10 çështje, do ndahen në të gjithë trupën gjyqësore. Atë që është prezent në gjykatën mëmë dhe atë që do vijë e importuar nga gjykata tjetër.

**Marçela Shehu:** Edhe apeli, kur filloi funksionimin, me të njëjtat rregulla funksionoi.

**Alban Toro:** Nëse vëmë një pikë këtu për ta rregulluar, a ka ndonjë të keqe?

**Brikena Ukperaj:** Mund të sqaroj dy situata për këtë gjë?

Atëherë, gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm nuk funksionojnë si gjykata e apelit. Në gjykatën e apelit ne parashikuam rindarjen e çështjeve për të gjitha çështjet që nuk ishin bërë asnjë parashikim për seancë gjyqësore. Ishin çështje që flinin dhe thjesht kishin emrin e relatorit. Për të garantuar shpërndarjen e barabartë të ngarkesës së punës, ne thamë që këto do të rishortohen dhe tani gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë pothuajse brenda seksionit ku janë ngarkesë të barabartë pune. E kemi realizuar këtë gjë. Kur vijmë tek gjykatat e shkallës së parë, çështja në gjykatën e shkallës së parë nuk fle, vjen regjistrohët dhe fillon gjykimi. Në Tiranë ka çështje që vazhdojnë gjykimin. Edhe në Krujë, Dibër dhe Matin. Gjyqtari i Matit kur shkon në Dibër do shkojë me një shportë të vetën të çështjeve që ka filluar gjykimin. Këto çështje nuk rindahen. Pra secili gjyqtar shkon me shportën e vet.

Çështja që do të regjistrohet në Gjykatën e Apelit (shkallës së parë) të Juridiksionit të Përgjithshëm në datën 1 maj ose 2 maj i nënshtrohet shortit midis gjyqtarëve të kësaj gjykate. Ne e kemi thënë këtë tek rregullat e ndarjes së çështjeve me short.

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Marçela Shehu:** Që të kuptojmë diçka. Nuk e kemi tek çështjet e reja që regjistrohen. Se ajo është e qartë që do shortohen. Ti thua për backlog-un.

**Naureda Llagami:** Kruja vjen me 400 çështje. Vjen tek Tirana me 3000 çështje.

Përveç penale dhe civile, mund të ketë 100 civile, pjesën tjetër e ka penale.

Mendoj që Kryetari duhet të fusë në short vetëm pjesën e Krujës dhe e lë Tiranën, ose Albani ka të drejtë, se 2500 çështje...

**Alban Toro:** Gjyqtarët e rinj që i çuam pikërisht për të mbushur boshllëqet në civile...

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Brikena Ukperaj:** Është edhe një qëndrim i mbajtur nga Gjykata e Lartë. Nëse çështja fillon të gjykohet, nuk mund t'ia marrësh gjyqtarit çështjen dhe ta shpërndash, – e para. Ne nuk e dimë në fakt nëse gjyqtarët nuk kanë kryer asnjë veprim. Nëse ne do ta parashikojmë këtë në çdo vendim kuadër, kam frikën se asnjë gjyqtar nuk do vërë dosjet në lëvizje tërë prillin. Sepse do thotë, – pse t'i vë në lëvizje dosjet kur këto do shortohen midis gjithë të tjerëve? Kjo do na ndodhë në gjykata të vogla. Do na ndodhë, sepse në qoftë se ne e vendosim si parashikim.. – e para. Dhe e dyta, pse nuk është parashikuar, ne thamë që në momentin që fillonin gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, këshilli i gjykatës ka vetë kompetenca për të vendosur rindarjen e çështjeve. I mbledh të gjitha çështjet që ka në gjykatë. Shikon për secilin gjyqtar cilat janë çështjet që nuk është kryer asnjë veprim procedural, në kuptimin që nuk është bërë

as komunikimi i padisë, se po u bë ajo ti nuk e rindan çështjen. Dhe pastaj vetë ajo merr masa për të rindarë ato midis të gjithë gjyqtarëve, ose mund t'i rindajë midis gjyqtarëve që kanë ngarkesë më të vogël. Por duke e vënë si parashikim të përgjithshëm, e para, justifikojmë ligjërisht faktin që nuk kryhet asnjë veprim dhe dosja fle.

**Alban Toro:** Në fakt ashtu ndodh, sepse teknikisht ai 3000 dosje nuk i evadon dot, as nuk njofton dot, as nuk shpërndan dot. Pra nëse Këshilli nuk ka ndërmend të ndërhyjë, hajde ndërhyjmë neve me këtë dispozitë.

**Marçela Shehu:** Tek vendimi nr. 554, 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”, tek pjesa e përjashtimit të gjyqtarit nga shorti, pika e pestë është parashikuar: Në rast nevojë të diktuar nga ngarkesa e pabarabartë e punës midis gjyqtarëve, ku mekanizmi i rindarjes së çështjeve nuk mund të realizohet, kryetari me vendim të arsyetuar përjashton plotësisht ose pjesërisht gjyqtarin nga ndarja me short të çështjeve, deri në sigurimin për aq sa është e mundur, të një ngarkese pune të barabartë.

Si e kuptoj unë, se jeni gati për të kundërshtuar pa e mbaruar. Unë e kuptoj që kryetari mundet që të përjashtojë disa gjyqtarë me ngarkesën më të madhe nga shorti, derisa të vijë një moment që ngarkesa mund të barazohet deri diku. Ky mendoj që është mekanizmi.

**Alban Toro:** Dakord Marçela! Cili është risku ta vendosim edhe këtë parashikim? Nuk po them që t'i heqim çështjet. Po flas, për çështjet në gjykim nuk ka njeri në botë që t'ia heqë. Po flas për ato çështje që ai ka të regjistruara në emrin e vet. Janë 3000 çështje në civile. 3000 çështje si do t'i bëj? Do t'i mbaj unë akoma? Do t'i shpërndash pra. Në qoftë se ky kryetar është jo sensibil, apo këshilli; në qoftë se këshilli është jo sensibil dhe nuk i shpërndan, hajde ta identifikojmë problemin dhe ta vendosim, se këtë kemi detyrë. Detyra jonë kjo është, që të gjithë gjyqtarët të kenë një ngarkesë. Nuk funksionoi ajo rregullore për ta bërë atë shpërndarje, vendosim klauzolën këtu. Pastaj, ndoshta edhe këtë nuk e respektojnë, por le bëhet objekt lënde për ILD-në.



**Marçela Shehu:** Ne po punojmë për miratimin e rregullave për rindarjen e çështjeve. Deri në atë moment unë mendoj që me atë vendimin që kemi në fuqi, kryetari mund të vijojë me përjashtimin e disa gjyqtarëve, me qëllim mbushjen e gjyqtarëve të tjerë sepse i bie që ne të parashikojmë këtë rregull vetëm për Gjykatën e Tiranës.

**Alban Toro:** Në Tiranë është dukshëm evidente.

**Marçela Shehu:** Vetëm Tirana, sepse dukshëm gjyqtarët e rretheve nuk lënë çështjet pa vënë në lëvizje.

**Alban Toro:** Mendoni që ezaurohet me atë? Dakord, e lëmë atëherë.

Atëherë, kalojmë tek pjesa e dytë. Për Tiranën po kërkoj ndërhyrje tjetër, që konsiston në këtë fakt. Duke pasur gjithmonë eksperiencën e keqe sepse ato detyrimisht të detyrojnë që të bësh rregullim përkatës. Paragrafin e dytë e kam konceptuar në këtë formë dhe vlen për ato gjykata që kanë seksione.

Tek 6, një paragraf shtesë (mund të jem edhe gabim, por e diskutojmë): “Këshilli i gjykatës, pasi ka marrë mendimin e gjyqtarëve, në përputhje me vendimmarrjen e KLGJ-së për caktimin e gjyqtarëve, ngarkesën specifike të çështjeve në gjykatë, rikrijon seksionet me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatës dhe uljen e ngarkesës së gjyqtarëve”. Kjo ka marrë spunto nga fakti i interpretimit të vendimmarrjes së fundit të KLGJ-së, jo vetëm nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë por edhe apelit, që me 1800 çështje civile ngarkojnë dhe formatojnë më shumë trupa gjyqësore në penale sesa në civile, kur dukshëm ato janë 1800 çështje, që kanë edhe masat e sigurimit. Ky tjetri në Tiranë ka 3000 çështje civile. Dukshëm formaton më shumë penale sesa civile. Tani nuk mund të vazhdojë kështu dhe të themi që edhe këtë aspekt e rregullojnë rregulloret e tjera. Kështu që unë mendoj që kjo të paktën të futet për t’i disiplinuar dhe të njohin autoritetin që KLGJ-ja konform nenit 89 të ligjit 115 e ka detyrimin që të krijojë ngarkesë të barabartë për të gjithë gjyqtarët. Kështu që këtij propozimi i mbetem deri në fund. E

votojmë.

**Marçela Shehu:** Diskutimi është i hapur, por si anëtare e grupit të punës, besoj e thotë edhe Iliri, po punohet për miratimin e rregullave për ndarjen në trupa dhe seksione. Kështu që mendoj që nuk është ky vendi dhe akti për ta parashikuar. Nëse mendoni një parashikim provizor deri në miratimin e atij akti, s'e di, por nuk besoj që...

**Naureda Llagami:** Këto rregulla për seksionet do jenë pjesë e muajit prill, që të na vihen në dispozicion? Në qoftë se ne i bëjmë aty, e adresojmë dhe shqetësimin që ka Albani tek ato.

**Ilir Rusi:** Po, e nderuar Kryetare!

Në vijim të axhendës së grupit të punës është parashikuar që në muajin prill, maksimalisht në maj, të miratohen këto, së bashku me aktet për fazën e tretë që kanë të bëjnë me gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ.

**Alban Toro:** Çfarë problemi ka ta vendosim këtu dhe ndërkohë që punohet për atë rregullore që ju thoni (se nuk e di çfarë do preki ajo rregullore). Ata e kanë tashmë të rregulluar këtë pjesë të problemit. Në rregulloren tjetër e ka me detajime.

**Ilir Rusi:** Po, sepse ky është vendim kuadër dhe ai është një rregull i përkohshëm i cili do gjejë zgjidhje në një moment të dytë, por shumë afër, në një të ardhme shumë të shpejtë. Kjo është ideja domethënë.

**Alban Toro:** Po përplasja/kolizioni ku është këtu tani, se s'po e kuptoj?

Unë synoj të rregulloj diçka që tani, ju thoni ta rregullojmë pas një muaji me detaje.

**Ilir Rusi:** Sepse kjo do hyjë në fuqi në datën 1 maj dhe ne shpresojmë se në maj

do miratohen aktet për rindarjen e çështjeve me short dhe për krijimin e trupave gjykues. Kështu që e njëjta kohë do shkojë, vetëm çështje ditësh do lëvizë.

**Alban Toro:** Po mirë, rrëzoheni!

**Marçela Shehu:** Ai është një akt që kërkon pak punë, pra po punohet me partnerët që asistojnë Këshillin, me ekspertët, sepse duhet të jetë një akt i detajuar. Kriteret për ndarjen e trupave dhe seksioneve duhet të jenë të menduara dhe të detajuara siç duhet. Prandaj mendoj që në këtë vendim, me një dispozitë nuk mund ta rregullojmë çështjen e ndarjes së seksioneve dhe trupave. Duke qenë se brenda prillit ne do ta mendojmë që ta paraqesim në plenare për ta miratuar, nuk besoj se deri në atë kohë mund të jetë problem.

**Ilir Rusi:** Sepse edhe ky vendim kuadër hyn në fuqi në datën 1 maj. Nuk hyn përpara.

**Alban Toro:** Backlog-u do vazhdojë të ekzistojë atje. Kështu që, me shpresën që diçka do përmirësohet në të ardhmen kur të miratohet ajo rregullorja tjetër, do të rregullohet si fenomen. Unë në opinionin tim nuk e shikoj që ka kolizion midis këtij rregullimi specifik për këtë rast me rregullimin më të detajuar me.. (shkëputje e audios).

Kështu që le ta hedhim. Rrëzoheni! S'ka problem.

Unë kam vendosur dy kritere: ngarkesa specifike për të gjithë të jetë e barabartë dhe vendimmarrja e KLGJ-së të respektohet. Çfarë po kërkoj unë? Autoritetin. Ruajmë autoritetin.

**Marçela Shehu:** Nuk besoj se është njeri kundër që të vendosen ca parime për të respektuar autoritetin. Problemi është që duhet të jetë një akt i mirëdetajuar, i mirëmenduar, me ca kritere me shumë.

**Naureda Llagami:** Ndoshta grupi i punës, këtë që Albani e ka si propozim, ta marri dhe ta inkorporojë tek pjesa e akteve dhe të na përcillet akti përpara hyrjes në fuqi (më 1 maj), me qëllim që shqetësimi i Albanit të adresohet siç duhet dhe pse jo edhe të...

**Marçela Shehu:** Nuk është vetëm shqetësimi i Albanit në fakt, sepse është shqetësimi i të gjithëve.

**Naureda Llagami:** I të gjithëve. Dhe sidomos tek gjykatat që ka backlog, kjo gjë duhet të kihet shumë kujdes. Aty ku ka backlog duhet të kemi një shpërndarje të drejtë, se prandaj po plotësohen vakancat, që të kemi shpërndarje të drejtë të ngarkesës, jo të kemi shpërndarje jo të drejtë siç ndodh në disa gjykata.

Kështu që, në këtë pjesë unë parimisht jam dakord, thjesht ta adresojmë tek akti që ka të bëjë me...

Fillojmë me propozimin e parë që bëri Brikena.

**Ilir Rusi:** Për saktësim, preken dy akte sipas propozimit të zonjës Ukperaj, akti që ka të bëjë me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe ai i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në lidhje me aktin e Gjykatës së Durrësit, tek neni 2, pika 2, zonja Ukperaj propozon që (në perifrazim): “Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm/të përkohshëm”, duke përshtatur edhe aktualitetin me transferimet e përkohshme që janë bërë në këtë gjykatë. Tek pika 4, të formatohet edhe një herë, duke lënë në fuqi vetëm “lëvizjet paralele”, për shkak se procesi i transferimeve ka përfunduar në këtë gjykatë. Ndërsa në lidhje me nenin 3, pika 5, këtu nuk preket sepse ka një tjetër përbërje Këshilli i Gjykatës së Durrësit.

Ndërsa në lidhje me aktin që parashikon Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është i njëjti argument për nenin 2, pika 2, ku sipas perifrazimit “Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm/të përkohshëm”. Pika 4 e nenit 2, parashikimi në lidhje me transferimet të hiqet sepse ka përfunduar procesi i

transferimeve në këtë gjykatë dhe të vazhdohet vetëm me lëvizjet paralele. Diçka tjetër që kishte po në këtë akt të Tiranës, tek neni 3, pika 5, kishte në lidhje me perifrazimin “aktuale”.

**Brikena Ukperaj:** Meqenëse Këshilli vlerëson që del kuptimi...

**Ilir Rusi:** Ok! Ju hiqni dorë nga propozimi i kësaj. Kështu që, qëndron me këtë përbërje.

**Naureda Llagami:** Me këto propozimet e bëra nga zonja Ukperaj, jeni dakord si grup i punës?

**Ilir Rusi:** Po, Iliri dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord. Kalojmë në votim.

Iliri dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

(Miratohen propozimet e zonjës Ukperaj.)

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek propozimi që ka bërë zoti Toro, që lidhet me nenin 6, që t’i shtohet një paragraf, pra nga paragrafi një të kalojë tek paragrafi dy i këtij neni. Mund ta perifrazosh edhe një herë Alban?

**Alban Toro:** Atëherë “Këshilli i gjykatës, pasi ka marrë mendimin e gjyqtarëve, në përputhje me vendimmarrjen e KLGJ-së për caktimin e gjyqtarëve, ngarkesën specifike të çështjeve në gjykatë, rikrijon seksionet me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatës dhe uljen e ngarkesës së gjyqtarëve”, – neni 6, paragrafi i dytë.

**Ilir Rusi:** Është hera e parë që unë argumentoj një votim, por do doja që në koherencë, ky perifrazim i shkon për shtat situatës, por meqenëse jemi në hartimin e sipër të akteve në një të ardhme shumë të shpejtë, dhe u theksua edhe nga zonja Shehu që është anëtare e grupit të punës së hartës, po e theksoj edhe unë në raport me axhendën e caktuar, në datën 7 prill unë kam lënë një mbledhje të grupit të hartës. Prej ditësh u kam dërguar përsëri një kujtesë anëtarëve të grupit të punës duke iu theksuar, së pari iu kam thënë “aktin e rindarjes së çështjeve me short”, dhe së dyti “aktin për krijimin e trupave gjykues dhe seksioneve”. Pavarësisht se kjo do hyjë në fuqi sot ose nëse do miratohen këto akte me botimin e tyre në fletoren zyrtare, por mendoj të botohen sa më shpejt për shkak nevojës që kanë këto akte dhe që lidhen me miratimin e akteve të tjera, dhe duke qenë se zbatimi i këtyre akteve do të fillojë në datën 1 maj, mendojmë se deri në atë moment kohor ne do kemi miratuar një akt tjetër i cili gjen rregullim ky perifrazim. Nuk jam kundër në raport me përmbajtjen, por jam kundër për shkak të momentit kohor kur ne jemi duke miratuar një vendim kuadër “Për funksionimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

**Irena Plaku:** Kundër.

**Dritan Hallunaj:** Kundër, për procedurë.

**Ridvan Hado:** Kundër.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Kundër, bazuar në arsyetimin që bëra.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Kundër, duke aprovuar dhe pasur edhe unë të njëjtin mendim si

zoti Rusi.

**Naureda Llagami:** Kundër, për procedurë.

(Nuk miratohet propozimi i zotit Toro.)

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në tërësi të gjithë aktet me ndryshimet përkatëse që u miratuan. Kalojmë aktin e parë që është fillimi i funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Pjesërisht dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, miratohet akti i parë “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në hedhjen në votim të aktit të dytë që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me gjithë ndryshimet e miratuara të propozuara nga zonja Ukperaj. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, miratohet dhe ky akt.

*Naureda Llagami*: Kalojmë tek akti i tretë që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Jemi dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni?

*Ilir Rusi*: Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

U miratua.

*Naureda Llagami*: Kalojmë tek akti i radhës që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, me propozimin e ardhur nga Komisioni.

*Ilir Rusi*: Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.



*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

U miratua.

*Naureda Llagami*: Kalojmë tek akti i radhës që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

*Illir Rusi*: Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, miratohet dhe ky akt.

*Naureda Llagami*: Kalojmë tek akti i radhës “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

*Illir Rusi*: Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.  
*Fatmira Luli*: Dakord.  
*Marçela Shehu*: Dakord.  
*Yllka Rupa*: Pro.  
*Brikena Ukperaj*: Pro.  
*Naureda Llagami*: Dakord.  
Miratohet.

*Naureda Llagami*: Kalojmë tek akti i radhës që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës. Jemi dakord me aktin e ardhur nga Komisioni?

*Ilir Rusi*: Dakord.  
*Irena Plaku*: Pro.  
*Dritan Hallunaj*: Pro.  
*Ridvan Hado*: Dakord.  
*Alban Toro*: Dakord.  
*Fatmira Luli*: Dakord.  
*Marçela Shehu*: Dakord.  
*Yllka Rupa*: Pro.  
*Brikena Ukperaj*: Pro.  
*Naureda Llagami*: Dakord.  
Miratohet.

*Naureda Llagami*: Kalojmë tek propozimi tjetër i Komisionit “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Jemi dakord?

*Ilir Rusi*: Dakord.  
*Irena Plaku*: Pro.  
*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.  
*Alban Toro*: Dakord.  
*Fatmira Luli*: Dakord.  
*Marçela Shehu*: Dakord.  
*Yllka Rupa*: Pro.  
*Brikena Ukperaj*: Pro.  
*Naureda Llagami*: Dakord.  
Miratohet.

*Naureda Llagami*: Kalojmë tek akti i fundit që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, së bashku me ndryshimet e miratuara nga Këshilli, bërë nga zonja Ukperaj. Jemi dakord?

*Illir Rusi*: Dakord.  
*Irena Plaku*: Pro.  
*Dritan Hallunaj*: Pro.  
*Ridvan Hado*: Dakord.  
*Alban Toro*: Dakord.  
*Fatmira Luli*: Dakord.  
*Marçela Shehu*: Dakord.  
*Yllka Rupa*: Pro.  
*Brikena Ukperaj*: Pro.  
*Naureda Llagami*: Dakord.  
Miratohet.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 28.03.2023)*

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

2.1 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;

2.2 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”;

2.3 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;

2.4 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 15:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)

3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte (EWMI-INL).*
6. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
8. *Të tjerë: Birn.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:
  - 2.1 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Berat;

2.2 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”;

2.3 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;

2.4 Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve, edhe këto të hartuara nga grupi i punës për zbatimin e hartës dhe të propozuara në plenare nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, dhe që kanë të bëjnë me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap z. Rusi.

*Ilir Rusi:* Faleminderit Kryetare!

Meqenëse, natyra e akteve është pothuajse e njëjtë, thjesht ndryshon vetëm se ku ushtrojnë funksionet gjykatat dhe nëse bashkohen me gjykata të tjera. Disa momente të cilat u përmendën në relacionin e parë nuk po i përmend për shkak që të mos biem në përsëritje. Do kalojë në lidhje me ato gjëra të cilat janë specifike në lidhje me këto katër akte që jemi duke i diskutuar, në lidhje me Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Sarandë, Vlorë dhe Elbasan.

Sa i përket natyrës së aktit:

Aktet që i paraqiten për miratim Këshillit janë akte normative nënligjore, të cilat janë të harmonizuara me misionin, vizionin dhe vlerat thelbësore të pushtetit gjyqësor, si dhe Objektivin Strategjik 3 të Planit Strategjik të KLGJ-së, vitet 2022 – 2024, që synon përmirësimin e ofrimit të shërbimeve efikase përmes miratimit dhe zbatimit të Hartës së re Gjyqësore, novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë që garantojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë.

Projektvendimet pasqyrojnë tërësinë e parimeve që do të udhëheqin procesin e zbatimit të riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, duke synuar vijimësinë në drejtimin dhe ofrimin e shërbimeve gjyqësore, administrative dhe atyre mbështetëse nga Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë, në datën 1 maj 2023.

Parimi kryesor mbi të cilin bazohet përmbajtja e këtyre projekt-akteve është ai i “gjykatave të riorganizuara” dhe jo ai i krijimit të një “gjykate të re”. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, gjykatat krijohen vetëm me ligj. Vendimi i Këshillit të Ministrave në rastin konkret riorganizon kompetencat tokësore të Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm. Konkretisht për Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë, selitë dhe kompetencat tokësore të mëparshme nuk ndryshohen dhe ato vijojnë të ushtrojnë funksionet e tyre me seli përkatësisht në qytetin e Beratit, Elbasanit, Sarandës dhe Vlorës dhe kompetenca tokësore të lartpërmendura. Nga data 01.05.2023, këto gjykata do të vazhdojnë funksionin me emërtim të ndryshuar nga:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat në Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan në Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë në Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë të riemërtuara Gjykata të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë, vijojnë ekzistencën si persona juridikë. Fillimi i funksionimit si Gjykata të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë kërkon vendimmarrjen e Këshillit në drejtime si: ndryshimi i emërtimit, përcaktimi i

numrit të gjyqtarëve, miratimi i rregullave standarde për strukturën dhe organigramën.

Të gjitha dispozitat e projektvendimeve janë hartuar në frymën e dhe përçojnë të njëjtin parim, atë të “gjykatës së riorganizuar”, e cila vijon rregullisht ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore e administrative në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë pas datës 01.05.2023 me emërtimin “Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm”.

Parimet bazë mbi të cilat janë hartuar projekt-aktet përfshijnë garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit qytetarëve dhe përdoruesve të gjykatës në një gjykatë plotësisht funksionale në datën 1 maj 2023, parimin e efikasitetit në trajtimin e procesit të riorganizimit, mbajtjen në konsideratë të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale të gjykatave, përmbylljen e procesit të riorganizimit brenda afatit të caktuar dhe me transparencë.

Në lidhje me përputhshmërinë e aktit me standardet ndërkombëtare:

Projektvendimi është hartuar duke marrë në konsideratë standardet më të mira ndërkombëtare të cilat kanë udhëhequr procesin e vlerësimit dhe përgatitjes së hartës së re gjyqësore, që synojnë të garantojnë vijimësinë në ofrimin e shërbimeve, specializimin, racionalizimin e shpenzimeve publike.

Sa i përket konsultimit të aktit:

Ka qenë e njëjta metodikë në lidhje me aktet e mëparshme.

Sa i përket komenteve të përgjithshme mbi aktin:

Aktet e propozuara për miratim garantojnë vazhdimësinë dhe funksionalitetin e pandërprerë të shërbimeve në gjykatën e Beratit, Elbasanit, Sarandës dhe Vlorës. Në të njëjtën kohë i shërbejnë përmbushjes së nevojës për rritjen e efikasitetit të shërbimeve gjyqësore dhe shpërndarjes në mënyrë proporcionale të ngarkesës së punës midis të gjithë gjyqtarëve në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Konceptimi i këtyre akteve synon pasjen e vendimeve që orientojnë qartë vazhdimësinë e funksioneve në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë. Në të njëjtën kohë, pas miratimit këto vendime, i hapin rrugë miratimit të akteve të tjera të nevojshme që do të bëjnë të mundur



përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në këto gjykata dhe miratimit të rregullave standarde dhe organikës së gjykatës, miratimit të rregullave të administrimit të çështjeve gjyqësore.

Sa i përket shpjegimit mbi përmbajtjen e aktit:

Vendimet janë ndarë në 3 nene në tërësi.

Neni 1 parashikon vazhdimin e funksionimit të gjykatës nga data 01.05.2023 me emërtimin e ri. Gjithashtu në këtë nen parashikohet edhe selia e gjykatës, duke përcaktuar qytetin dhe adresën e saktë të saj. Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë në datën e fillimit të funksionimit si Gjykata të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë nga 1.05.2023, vijojnë veprimtarinë e tyre dhe vazhdojnë të ekzistuar si persona juridikë duke ndryshuar emërtimin e tyre si lartpërmendur. Parimi i “riorganizimit të kompetencave tokësore por jo krijimit të gjykatës së re”, pasqyrohet në këtë nen, duke ruajtur të njëjtat kompetenca tokësore dhe seli, nën një emërtim të ri Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë. Në kuadër të vijimit të ushtrimit të veprimtarisë, vlen të theksohet që Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë, veç ndryshimit të emërtimit të tyre, nuk është e nevojshme të pajisen me numër unik tjetër identifikimi, sepse nuk përbëjnë persona juridikë të rinj.

Bazuar në parimet e këtij neni, nga data 01.05.2023, Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë vijojnë të gëzojnë të njëjtin personalitet juridik, duke u ndryshuar vetëm emërtimi nga gjykatat e rrethit gjyqësor në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Neni 2 i vendimeve në lidhje me gjyqtarët e gjykatave Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë, nuk ka përcaktuar numër konkret, duke parashikuar nevojën e nxjerrjes së një akti të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me qëllim që në eventualitetin e ndryshimit të këtij numri në të ardhmen, të mos jetë e nevojshme ndryshimi i përmbajtjes së këtyre vendimeve.

Në nenin 3 të projekt-akteve parashikohet se rregullat standarde për strukturën, përshkrimet e punës dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë përcaktohen me

akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Drafti përkatës është duke u përfunduar nga grupi i punës.

Fjalia e fundit e vendimeve parashikon rregullin e hyrjes në fuqi nisur nga natyra e aktit si akt normativ nënligjor.

Për sa i përket zbatimit të aktit:

Zbatimi i akteve kërkon qasje proaktive nga të gjitha gjykatat, si organet drejtuese ashtu edhe administrata gjyqësore, për të bashkëpunuar ngushtësisht me Këshillin e Lartë Gjyqësor e për të siguruar vijimësi në ofrimin e shërbimeve, drejtësi efektive dhe në kohë për qytetarët.

Për sa i përket efekteve financiare:

Këto akte nuk krijojnë drejtpërdrejt efekte të tjera financiare për hartën e re gjyqësore, veç atyre të parashikuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në lidhje me përmbajtjen e akteve, tek pika 1 e secilit akt, në lidhje me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Elbasan, Vlorë dhe Sarandë, tek pika 1 të shtohet “1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat vazhdon funksionimin nga data 01.05.2023, me emërtimin Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat me seli në adresën: Rruga "Antipatrea", Lagja "Iliria", Berat. Sipas rastit duke vijuar me gjykatat e Sarandës, Vlorës dhe Elbasanit.

**Naureda Llagami:** Faleminderit zoti Rusi!

Kemi diskutime mbi propozimin e ardhur?

Nëse jo, kalojmë në votim një e nga një të gjithë aktet.

Akti i parë ka të bëjë me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, sipas propozimit të ardhur nga grupi i punës dhe Komisioni. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, miratohet fillimi i funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

*Naureda Llagami*: Kalojmë tek akti i radhës që edhe ky vjen sipas propozimit të Komisionit dhe grupit të punës, dhe që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Jemi dakord?

*Ilir Rusi*: Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Miratohet dhe ky akt.

*Naureda Llagami*: Kalojmë tek akti i tretë që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, sipas propozimit të Komisionit dhe grupit të punës. Jemi dakord?

*Ilir Rusi*: Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.  
*Ridvan Hado*: Dakord.  
*Alban Toro*: Dakord.  
*Fatmira Luli*: Dakord.  
*Marçela Shehu*: Dakord.  
*Yllka Rupa*: Pro.  
*Brikena Ukperaj*: Pro.  
*Naureda Llagami*: Dakord.  
Miratohet.

*Naureda Llagami*: Kalojmë tek akti i fundit që ka të bëjë me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Edhe ky akt vjen me propozimin e grupit të punës, miratuar nga Komisioni. Jemi dakord?

*Ilir Rusi*: Dakord.  
*Irena Plaku*: Pro.  
*Dritan Hallunaj*: Pro.  
*Ridvan Hado*: Dakord.  
*Alban Toro*: Dakord.  
*Fatmira Luli*: Dakord.  
*Marçela Shehu*: Dakord.  
*Yllka Rupa*: Pro.  
*Brikena Ukperaj*: Pro.  
*Naureda Llagami*: Dakord.  
Miratohet edhe ky projekt-akt.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 28.03.2023)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi dhe transferimin pa pagesë të gjeneratorit dhe UPS qendrore”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 15:15.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Rezarta Taushani, Maela Aicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Stefan Mano, specialist pranë Drejtorisë së Investimeve dhe Planifikimit Strategjik.*
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte (EWMI-INL).*
- 7. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 9. Të tjerë: Birn.*

**RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin për nxjerrjen nga përdorimi dhe transferimin pa pagesë të gjeneratorit dhe UPS qendrore”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës. Në fakt është një çështje që propozohet nga Komisioni i Administrimit dhe Buxhetit, ka të bëjë me miratimin për nxjerrjen nga përdorimi dhe transferimin pa pagesë të gjeneratorit dhe UPS-së qendrore.

Ju e dini shumë mirë që nga ana e Këshillit, në 2020, u mundësua sipas

propozimit të ardhur nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, blerja e një gjeneratori dhe UPS-i për të krijuar një mundësi për energji elektrike pa ndërprerje në godinën e re Poli i Drejtësisë, në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Por duke qenë se administrimi i kësaj godine bëhet nga Ndërmarrja Industriale nr. 1, atëherë është konceptuar që shpenzimet dhe të gjitha problematikat që ka ky gjenerator bashkë me UPS-in, të mbulohen nga kjo ndërmarrje e cila është pranë Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë. Kështu që, për këtë arsye propozohet nga struktura përkatëse dhe miratohet nga Komisioni pikërisht nxjerrjen nga përdorimi dhe transferimi pa pagesë të gjeneratorit dhe UPS-it qendror.

Për më shumë detaje kam këtu edhe specialistin përkatës, i cili, nëse ju kërkoni informacion të detajuar, mundemi që t'ju vëmë në dispozicion.

**Brikena Ukperaj:** Kam një pyetje.

Unë mbaj mend diskutimin që kemi pasur në plenare në fakt për çështjen e këtij gjeneratori. Ky gjenerator nxirret nga përdorimi, sepse nuk funksionin?

**Naureda Llagami:** Nuk e kemi nxjerrje jashtë përdorimit. Nxirret jashtë përdorimi kur ai është i amortizuar. Thjesht i kalohet... Është termi i duhur në aspektin..

**Stefan Mano:** Nëse më lejoni?

Të gjithë këto terma rrjedhin nga Udhëzimi 30 i Ministrisë së Financave, i vitit 2011 që presupozon, një aktiv i cili është i panevojshëm për njësinë publike mund të nxirret nga përdorimi ose jashtë përdorimit. Rasti “nga përdorimi” është rasti i aktivit i cili ka akoma vlerë përdorimi dhe mund të përdoret në një njësi tjetër publike. Ne këtij rasti i referohemi. Ndërsa “nxjerrja jashtë përdorimit” është një aktiv i cili nuk mund të përdoret më, është jashtë përdorimit, nuk kryen funksionin e tij dhe ka disa procedura që asgjësohet ose shitet si rikupero në njësitë që blejnë rikuperot ose materialet e riciklueshme. Ne i referohemi termit “nga përdorimi”, domethënë nuk e përdorim, nuk e menaxhojmë ne, por ia kalojmë një njësie tjetër për ta menaxhuar. Gjeneratori është në gjendje pune dhe është funksional.



Ne e nxjerrim nga përdorimi, administrimin pastaj e kanë ato.  
Deri tani e kemi administruar ne, se ka qenë në garanci.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

*Sqaron znj. Llagami:*

**Naureda Llagami:** Ka një komunikim me Ndërmarrjen që është në varësi të Ministrisë së Financave, dhe pastaj ka ardhur si propozim. Kështu që ky është një term që ato (MF) e përdorin kur ne kalojmë një aktiv.

Pra buxheti i KLGJ-së të mos mbajë më kosto mirëmbajtjeje për sa kohë këto kosto, me VKM, i kanë kaluar Ndërmarrjes. Pse t'i mbajë buxheti ynë, kur duhet t'i mbajë buxheti i Ndërmarrjes. Edhe kemi dakordësuar pra, se ky propozim vjen pas një komunikimi shkresor bërë me Ndërmarrjen, që i kemi kërkuar, sepse komplet menaxhimi dhe administrimi është i Ndërmarrjes (qoftë për ujë, qoftë për drita, për të gjitha).

Edhe kur e kemi blerë neve, ne na ka autorizuar Ministria e Financës duke na thënë që duke qenë se në ato momente Ndërmarrja nuk e kishte marrë në dorëzim “Polin e Drejtësisë” (ne s’kishim ardhur këtu, ishim akoma tek zyrat e vjetra dhe nuk ishte bërë administrimi), na pati orientuar që ta blinim ne, por duke marrë parasysh që do shkonim tek “Poli i Drejtësisë”, ku Ndërmarrja do të ishte administratore. Ne e patëm blerë dhe na patën lejuar të zëri i buxhetit për blerjen e tij. E keni të referuar në fakt tek relacioni që atëherë ato na lejuan ta blinim, duke qenë se Ndërmarrja nuk mund ta bënte në atë kohë sepse s’ishite akoma administratore e kësaj ndërtese. Po të shihni, edhe VKM-ja që ka dalë, ka dalë më mbrapa se sa kur kemi vepruar neve.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

**Naureda Llagami:** Që ta dini, ne nuk kemi asnjë gjë në pronësi në këtë ndërtesë. Administrimi dhe pronësia e ndërtesës është e Ndërmarrjes nr. 1 të Financave. Marrëveshja jonë është thjesht një marrëveshje hua-përdorje.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

*Vijon sqarimi:*

**Naureda Llagami:** Deri tani (gjeneratori) ka qenë tek kostot e KLGJ-së. Në kushtet që tani ka një Ndërmarrje dhe VKM-ja thotë që Ndërmarrja është përgjegjëse, pse duhet ta marrim ne këtë kosto dhe këtë përgjegjësi? Atëherë, ne kemi dakordësuar për t'ia kaluar asaj, duke hequr në këtë lloj mënyre, nga zëri i buxhetit tonë, pjesën e shpenzimeve që harxhohim për buxhetin. Sepse i mbanim ne, ndërkohë që përfitonin (ju e mbani mend debatin), përfiton edhe Shkolla, përfiton edhe KLP-ja. Ndërkohë që, pse ta mbajmë ne si pjesë buxheti? E mban Ndërmarrja e cila administron të gjithë ambientet tona.

**Stefan Mano:** Deri tani gjeneratori ka qenë në kontratë garancie 2 vjet, deri në dhjetor të vitit 2022. Ne nuk kemi harxhuar asnjë lekë, por kemi harxhuar vetëm për naftën. Me naftë e kemi furnizuar dy-tre herë, sepse ka qenë problematika e tillë. Neve gjeneratorin e transferojmë si aktiv. Nuk është më në inventarin e KLGJ-së, është në inventarin e ndërmarrjes dhe meqë gjeneratori është inkorporuar në godinën që mirëmbahet nga Ndërmarrja, i atashohet ndërmarrjes dhe përgjigjet ajo. Termi i saktë është “transferim pa pagesë”, jo dhurim. Transferim pa pagesë. Është ent publik. Është njësi publike.

*Në vijim sqarohet:*

**Naureda Llagami:** ... Ministria e Financës është shprehur që duhet ta merrni ju tek buxheti, duke qenë se s'ia dha KLP-së dhe Shkollës së Magjistraturës, meqë KLGJ-ja prezumohet që të kishte sipërfaqen më të madhe të kësaj godine në përdorim.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

**Naureda Llagami:** Na udhëzuan ato. Urdhëro, keni buxhetin, merreni përdoren. Tani po ia kalojmë në përdorim atyre.

**Stefan Mano:** Të gjithë përgjegjësinë ta marrin ato. Kjo është e gjithë historia.

**Marçela Shehu:** (Pa mikrofon) Nëse ne nuk e bëjmë këtë transferim...?

**Stefan Mano:** Ato kanë kërkuar zyrtarisht që të transferohet gjeneratori... quhet aset i godinës, sepse ato përgjigjen dhe kanë një kontratë me tre institucionet, dhe duan ta kenë të tyren.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

**Stefan Mano:** Ju lutem?

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

**Stefan Mano:** Ndërmarrja do përgjigjet që sot e tutje.  
Në përgjigje të pyetjes se sa ka kushtuar gjeneratori:  
Diku tek 5 milion lekë të reja. 51 milion, 52 milion lekë të reja. (Korrigjohet vlera). Jo, jo, 51 milion lekë të vjetra.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

**Stefan Mano:** Udhëzimi është i qartë.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

**Naureda Llagami:** Po, sillnim naftën tonë. Ndërkohë që tani pse e kemi ne këtë?

Ta mbajnë ato, se ato mbajnë përgjegjësi edhe për të tjerat.

E hedhim në votim.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e nxjerrjes nga përdorimi dhe transferimin pa pagesë të gjeneratorit dhe UPS-së qendrore, te Ndërmarrja Industriale nr.1, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila ka në përgjegjësi administrimi godinën “Poli i Drejtësisë”.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 28.03.2023)*

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr.504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 15:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Alban Toro*** (anëtar)

8. *Marçela Shehu* (anëtare)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte (EWMI-INL).*
6. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
8. *Të tjerë: Birn.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr.504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr.504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Toro.

***Alban Toro:*** Faleminderit!

Me vendimet respektive nr. 502, nr. 503, dhe nr. 504, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor ka filluar procedura e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në fushën e të drejtës penale; hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, në fushën e të drejtës penale dhe hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, në fushën e të drejtës penale.

Nga ana e Këshillit është caktuar gjithashtu relatori dhe nga ana e relatorit është bërë e ditur gjyqtares, ndër të tjera dhe kandidates {...}, për ekzistencën e ndonjë shkakut në lidhje me anshmërinë apo jo të ndonjë anëtari apo të relatorit në procedurat e verifikimit.

Ndërkohë, në vijim të procedurave të verifikimit për tre kriteret ligjore të kandidimit, kandidatja znj. {...}, me anë të komunikimit elektronik të datës 17.03.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke parashtruar se: “Në vijim të komunikimit tonë elektronik, për sa i përket procedurës së ndjekur nga ana juaj për ngritje në detyrë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimet nr.502, 503 dhe 504, të datës 21.11.2022 (pra bëhet fjalë pikërisht për pozicionet e hapura pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ish-apelit Durrës dhe ish-apelit Korçë), ju paraqes kërkesën time për heqje dorë nga të tre aplikimet”.

Në këto rrethana, duke respektuar vullnetin e gjyqtares për tërheqje nga kualifikimet për këto tre pozicione, u përgatit ky relacion dhe projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të

Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këto pozicione.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*Naureda Llagami:* Atëherë, nëse s’kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga relatori.

*Ilir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Pro.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Yllka Rupa:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këto pozicione.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,



si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 28.03.2023)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2022, për gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 15:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Yllka Rupa** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.**

**4. Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte (EWMI-INL).**

**6. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**

**7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

**8. Të tjerë: Birn.**

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2022, për gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2022, për gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...}. Fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

***Brikena Ukperaj***: Faleminderit zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 11 – nr. 20, datë 18.01.2023 ka hapur 10 (dhjetë) procedura për lëvizje paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për 10 (dhjetë) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile. Në të njëjtën datë, Këshilli me katër vendime ka hapur edhe 4 (katër) procedura për lëvizje paralele për 4 (katër) pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për secilin nga pozicionet, Këshilli pasi ka verifikuar përvojën profesionale të secilit nga kandidatët gjyqtarë dhe ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për secilin prej tyre, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, në pikën e parë të tij, ka vendosur miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11 – nr. 24. Në këtë listë, si gjyqtarë që mund të kenë dy vlerësime, janë përfshirë gjyqtarët e mëposhtëm: Z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}.

Për dymbëdhjetë gjyqtarët e mësipërm, në relacionin e miratuar nga Këshilli, në kuadër të vendimit nr. 77, datë 13.02.2023, është konkluduar se:

1) Për gjyqtarin {...}, mund të ketë dy vlerësime etike–profesionale, për të cilat Këshilli ka filluar procedurat e vlerësimit, konkretisht një gradim dhe një vlerësim të dytë 3-vjeçar, periudha 2017–2019.

2) Për gjyqtaren {...}, mund të ketë 2 vlerësime, pasi Këshilli e ka miratuar raportin e vlerësimit me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013–2016, ndërsa vlerësimi i dytë konsiderohet ai 3–vjeçar periodik 2017–2019, i cili është në proces.

3) Për gjyqtarin {...}, mund të ketë dy vlerësime, për të cilat Këshilli ka filluar procedurat e vlerësimit, konkretisht një gradim i cili është përfunduar dhe i është përcjellë mbledhjes plenare, dhe një vlerësim të dytë që përkon me vitin kalendarik 2021, në kushtet kur ky gjyqtar kishte aplikuar edhe për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë. Edhe vlerësimi i dytë i këtij gjyqtari është në proces.

4) Për gjyqtaren {...}, mund të ketë dy vlerësime, pasi gjyqtarja ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe është në procedurë gradimi. Ndërsa vlerësimi i dytë i saj është konsideruar vlerësimi periodik 3–vjeçar 2017–2019.

5) Për gjyqtarin {...}, mund të ketë dy vlerësime. Vlerësimi i parë është ai i gradimit, i cili është në proces. Ndërsa vlerësimi i dytë 3–vjeçar 2017–2019 është miratuar nga Këshilli.

6) Për gjyqtarin {...}, në kushtet kur gradimi i tij nuk mund të bëhet dhe Këshilli ka vendosur mosfillimin e procedurës së gradimit, është konkluduar që mund të ketë dy vlerësime: vlerësimi i parë është ai 3–vjeçar 2017–2019 i cili është në proces dhe vlerësimi i dytë për këtë gjyqtar është konsideruar vlerësimi i përshpejtuar i vitit të fundit kalendarik 2022 i cili propozohet të fillohet tani.

7) Për gjyqtarin {...}, e njëjta situatë si me gjyqtarin {...}. Vlerësimi i parë është konsideruar 2017–2019, i cili është në proces. Ndërsa vlerësimi i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i vitit kalendarik 2022.

8) Për gjyqtaren {...}, janë konsideruar dy vlerësime: gradimi dhe trevjeçar. Gradimi ka përfunduar, trevjeçari është për shqyrtim nesër në mbledhje plenare.

9) Për gjyqtarin {...}, është vlerësuar si vlerësim i parë një vlerësim i bërë sipas rregullave të ish–Këshillit të Lartë të Drejtësisë, vlerësimi “shumë mirë”, vlerësimi i parë i tij, në kushtet kur ai nuk kishte mbaruar procesin e rivlerësimit kalimtar, dhe vlerësimi i dytë është konsideruar ai trevjeçar 2017–2019 i cili është në proces.

10) Për gjyqtaren {...}, është konsideruar që mund të ketë dy vlerësime: vlerësimi i parë është 2017–2019 i cili është në proces dhe vlerësimi i dytë për këtë gjyqtare është vlerësuar që duhet të jetë ai i përshpejtuar i detyruar që përkon me vitin e fundit kalendarik, për të cilin propozohet të fillohet vlerësimi.

11) Për gjyqtarin {...}, është konsideruar që mund të ketë dy vlerësime, por për asnjë nga këto dy vlerësime nuk do të ishte ai i përshpejtuar. Janë shpjeguar në relacion.

12) Për gjyqtarin {...}, gjyqtari i fundit i listës së gjyqtarëve që mund të kenë dy vlerësime, është konsideruar që vlerësimi i tij i parë etik–profesional të ishte ai sipas dispozitave në kohë para hyrjes në fuqi të ligjit “Për statusin”, dhe vlerësimi i dytë do të

ishte vlerësimi i përshpejtuar për periudhën e vlerësimit që përkon me vitin kalendarik 2022.

Pra nga dymbëdhjetë gjyqtarët e përfshirë në këtë listë, bazuar në relacionin e miratuar nga Këshilli, vetëm për 4 (katër) prej tyre, Këshilli duhet të fillojë me përparësi procedurën e përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, dhe konkretisht për gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...}, të cilët kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit që përkon me vitin e fundit kalendarik, përkatësisht vitin 2022.

Lidhur me momentin se kur duhet të fillojë vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin e fundit kalendarik, që në rastin konkret përkon me vitin 2022, në nenin 97 të Ligjit për Statusin, i cili parashikon modalitetet e vlerësimit të përshpejtuar, parashikohet se: “...Këshilli miraton programin që përcakton magjistratët që vlerësohen, sipas kësaj procedure, para se të marrë vendim për ngritjen në detyrë ose transferimin e magjistratit...”

Bazuar në dispozitën e mësipërme si dhe nenin 25 të ligjit nr. 48/2019, dispozitë e cila i jep mundësi Këshillit që gjatë periudhës kalimtare, për aq kohë sa zgjat procesi i rivlerësimit kalimtar, të miratojë rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve për lëvizjes paralele ose ngritje në detyrë, në vendimin nr. 263/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në nenin 22 të tij, ka parashikuar se: “Gjatë periudhës kalimtare sipas nenit 25 të ligjit 48/2019, sa herë që kërkohet ngritja në detyrë ose lëvizja paralele, Këshilli bën vlerësim të përshpejtuar të detyruar të gjyqtarit. Për këtë vlerësim zbatohen rregullat e përcaktuara për vlerësimin e përshpejtuar me kërkesë, me afate të përgjysmuara nga ato të parashikuara në nenin 18 të këtij vendimi”.

Përparësia e fillimit të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional është parashikuar dhe miratuar nga Këshilli në programin e vlerësimeve për vitin 2023, si pjesë e planifikimeve 3-mujore të fillimit të procedurave të vlerësimit.

Vendimi nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, nuk ka një dispozitë konkrete që rregullon momentin e fillimit të procedurës së vlerësimit të përshpejtuar, si vlerësim i dytë i mundshëm për t’u kryer për gjyqtarët që kanë aplikuar për lëvizje paralele. Në pikën 75 të kreut VI të këtij vendimi

parashikohet se: “Procedura e përzgjedhjes fillon menjëherë pas përfundimit me vendim të formës së prerë të verifikimit të të gjithë kandidatëve dhe, kur është rasti, edhe të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”. Ky parashikim e bën të domosdoshëm përfundimin e procedurave të vlerësimit për të gjithë kandidatët e pozicionit, para fillimit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatit fitues. Ndërsa në pikën 115 të dispozitave kalimtare të këtij vendimi, parashikohet se për vlerësimin e përshpejtuar zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 22 të cituar më sipër në vendimin nr. 263.

Ndërkohë në çdo vendim të hapjes së procedurës së lëvizjes paralele për të gjitha pozicionet e shpallura në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë e Durrës, Këshilli ka parashikuar se “Për kandidatin e kualifikuar me vendim përfundimtar, me përjashtim të atij që përpara kandidimit ka qenë në një pozicion të komanduar në vitin e fundit kalendarik, fillon procesi i vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional sipas ligjit “Për statusin”, etj. Ky parashikim, që kemi bërë në çdo vendim të shpalljes së procedurave për lëvizje paralele, e kushtëzon fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar me kualifikimin e kandidatit, pra me plotësimin prej tij të kriterëve ligjore të kandidimit. Ky parashikim është bërë me qëllim kryerjen e procedurave efektive të vlerësimit të përshpejtuar, në funksion të procedurës së lëvizjes paralele dhe mosharxhimit e kohës dhe burimeve njerëzore për kryerjen e vlerësimeve të përshpejtuara për gjyqtarët që skualifikohen nga gara për shkak të mosplotësimit të kriterëve ligjore.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i kushtëzuar nga nevojat aktuale të diktuar nga gjendja e sistemit gjyqësor për shkak të zbatimit të hartës gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe nga urgjenca e diktuar nga plotësimi sa më shpejt i pozicioneve të shpallura për lëvizje paralele, në kushtet kur procedurat e përzgjedhjes për këto pozicione, nuk mund të fillojnë pa përfunduar të gjitha vlerësimet e kandidatëve për çdo pozicion, i propozon mbledhjes plenare sot fillimin e procedurave të vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për katër gjyqtarët e mësipërm, menjëherë, pa qenë i nevojshëm kualifikimi i tyre. Nevoja dhe urgjenca në fillimin e këtij vlerësimi diktohen nga:

- 1) Kohëzgjatja e procedurave të vlerësimit të përshpejtuar, kohëzgjatje e cila sipas

ligjit e akteve nënligjore kërkon minimalisht (nëse çdo gjë do të shkonte shumë mirë) 3 muaj kohë, afat që nëse do të miratohet ky propozim, fillon në muajin prill 2023 dhe përfundon në qershor 2023;

2) Fillimi i menjëhershëm do të mundësojë që gjatë muajit korrik 2023, Këshilli të miratojë renditjet dhe finalizojë procedurat e lëvizjeve paralele, çka jo vetëm do të lehtësojë ngarkesën e punës në gjykatat në nevojë, por do të mundësojë hapjen e vendeve të lira të përhershme për kandidatët gjyqtarë që priten të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës;

3) Fillimi i menjëhershëm i vlerësimit të përshpejtuar kushtëzohet në rastin konkret nga zbatimi i hartës së re gjyqësore, pasi mendimi i kryetarit si burim vlerësimi mund të merret vetëm nga zëvendëskryetarët në detyrë të gjykatave aktuale. Në kushtet kur dy prej gjyqtarëve janë pjesë e organikave të gjykatave që i bashkohen gjykatave më të mëdha (z.{...} dhe z. {...}), mendimi i kryetarit si burim vlerësimi mund të merret vetëm nga zëvendëskryetarët e këtyre gjykatave (Pukë dhe Pogradec), pa përmendur këtu vështirësitë që mund të na krijohen për shkak të procedurave të përzgjedhjes së dosjeve për vlerësim e dërgimin e tyre në Këshill.

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale vlerëson se, në kushtet e diktuar nga situata aktuale, me qëllim përfundimin në kohë të vlerësimeve të përshpejtuara të detyruara, Këshilli duhet të fillojë menjëherë këto procedura për katër gjyqtarët e mësipërm, pa pritur kualifikimin e secilit prej tyre për pozicionet ku ata kanë kandiduar. Në eventualitetin që gjyqtarët nuk do të kualifikohen për lëvizje paralele, Këshilli deklaron më pas me vendim përfundimtar e këtyre procedurave pa vendim përfundimtar. Nga ana tjetër, parashikimi i mësipërm në çdo vendim të hapjes së procedurave të lëvizjes paralele, për fillimin e vlerësimit të përshpejtuar vetëm për kandidatët e kualifikuar, ka natyrë diskrecionale (pra nuk buron nga ligji) dhe si i tillë në kushtet kur nuk buron nga një detyrim konkret i parashikuar në ligj, nuk ka pengesë të ndryshohet nga Këshilli, në funksion të administrimit sa më të mirë dhe efektiv të gjithë procesit të lëvizjes paralele pa cenuar të drejtat e gjyqtarëve kandidatë.



Procesi i vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 1 janar 2022 - 31 dhjetor 2022 do të zhvillohet mbi bazën e të njëjtave burimeve dhe rregullave të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore.

Për sa më sipër, Komisioni ka përgatitur (nëse edhe Këshilli është dakord me relacionin) projekt-aktin për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për katër gjyqtarët e cituar më lart.

Në pikën I të projektvendimit parashikohet konkretisht fillimi i procedurës së përsheptuar të detyruar për katër gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...}, për vitin kalendarik 2022, si periudhë vlerësimi.

Në pikën II parashikohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin të cilët caktohen nëpërmjet shortit. Bazuar në ngarkesën e secilit anëtar të Komisionit në punët e këtij Komisioni dhe në procedurat e vlerësimit të angazhuar deri tani, është propozuar që për anëtarën zonjën Brikena Ukperaj të shortohen 2 procedura vlerësimi, për anëtarën Yllka Rupa 1 procedurë vlerësim dhe për anëtarën Irena Plaku 1 procedurë vlerësim. Ndërsa lidhur me numrin e nëpunësve përgjegjës që do të angazhohen në vlerësimin etik dhe profesional, propozohet të përfshihen në short nëpunësit përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili dhe znj. Gilda Hoxha, duke siguruar një shpërndarje të barabartë të punës mes tyre (dy vlerësime secili nëpunës).

Së fundi, parashikohet dhe hyrja në fuqi e këtij projektvendimi, menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë ftoj administratën...

**Alban Toro:** Mundem?

**Naureda Llagami:** Po!

**Alban Toro:** Në fakt unë bashkohem me shqetësimin e Brikenës që kjo lloj

procedure do dojë një shpejtësi dhe kohë të shkurtër për t'u përfunduar, për efektin e pozicioneve të lira të përkohshme dhe për të konkluduar për t'i bërë përfundimisht të përhershme, në mënyrë që t'i japim mundësi edhe kandidatëve që do të vijnë nga magjistratura për t'u riintegruar nga trupat gjyqësore të gjykatave të tjera. Por kam frikë se me shpejtësinë e kryerjes së kësaj procedure në momentin aktual, kur akoma nuk ka mbaruar procedura e verifikimit, pa dashje do të cenonim një nga kriteret, që është paanësia, pra përjashtimi i çdo lloj dyshimi të arsyeshëm tek kandidatët se diçka ka ndaj tyre dhe mund t'jua ilustroj edhe me një shembull, duke përdorur edhe personazhe jo të kandidatëve. Po supozojmë që Albani nga Brikena vlerësohet me 400 pikë si gjyqtar, ndërkohë që Ridvani që është pasues i tij vlerësohet me 380. Ndërkohë që Albani, mbasi fillojnë procedurat e verifikimit, merr një vendim negativ ku ai ndalohet nga konkurrimi i mëtejshëm, sepse nuk plotëson kriteret. Atëherë, tek Albani krijohet qasja dhe dyshimi i arsyeshëm që dikush nga kandidatët po favorizohet dhe këtu ai evitohet në përfundim.

Duhet të jemi të sigurt. Natyra njerëzore është e ndryshme dhe prandaj quhet e tillë; mund të krijojë perceptime të ndryshme tek individit që, “mua nuk më duan të shkoj në Tiranë” (meqenëse po bëhet fjalë për Tiranën dhe Durrësin).

Kështu që, në këto kushte, duke e filluar këtë diskutim formalisht, do të ishte mirë jo formalisht. Pra që të bëhej një punë parapërgatitore, të bëhej një vlerësim i paformalizuar me vendim përfundimtar, por në momentin që të mbaronte procedura e verifikimit, çdo gjë pastaj të fillonte sipas stadi të dytë. Në fakt rregullorja ka bërë një metodikë dhe metodika e saj është që procedura e përzgjedhjes (ju e cituat) fillon menjëherë pas përfundimit me vendim të formës së prerë të verifikimit të të gjithë kandidatëve. Që do të thotë, mbaron verifikimi, si dhe kur është rasti, vlerësimi etik dhe profesional. Shikohen kush janë me një apo me dy, apo kur ka vlerësime, mbarohen edhe vlerësimet, dhe përfundohet, duke evituar në këtë formë çdo perceptim të gabuar tek individit kandidat që diçka po luhet në kurriz të tij. Fatkeqësisht kjo do ndodhë nëse ne do të miratojmë këtë lloj vendimi sepse me të vërtetë kandidatëve do t'u krijohet perceptimi që këta po ma ngulin.

**Brikena Ukperaj:** Ne në fakt edhe kur kemi bërë ngritjet në detyrë edhe kur bëmë lëvizjet paralele, kemi parashikuar që vlerësimi i përshpejtuar i detyruar do të fillojë nëse gjyqtari kualifikohet. Nuk është as në rregullore, as në ligj, por në aktet kur kemi shpallur edhe procedurat, kemi vendosur me qëllim që mos të fillojmë procedura për një gjyqtar që nuk kualifikohet.

Tani Alban, këto procedura bëhen për tre muaj. Sa e mendon ti afatin që të duhet për të kualifikuar një kandidat? Janë pozicione të shpallura në janar. Nëse ne do të presim të kualifikohen të gjithë kandidatët (bëhet fjalë për katër kandidatë), atëherë ka gjasa që të mos i fillojmë dot as në maj. Në qoftë se fillojnë më shpejt, atëherë nuk do të kenë problemin e pikëve, sepse ata do jenë të kualifikuar. Këto procedura, që të respektohen afatet, duan tre muaj. Pra këto procedura nuk mbarojnë dot për tre muaj. Sepse ka dy muaj “mendimi i kryetarit dhe dërgimi i akteve”. Me afate të përgjysmuara flas. Pra nuk po bëjmë një gjë, thjesht po fillojmë procedurat, sepse të kemi mundësi. Nuk do kemi mundësi të marrim dosjet.

Të lutem Alban! Unë formalisht kam kërkuar të gjitha tabelat statistikore (i kemi). Nuk mund të bëjmë dot një urdhër shorti pa filluar procedura, sepse janë shkelje të rënda procedurale që shkojnë në gjykatë nesër–pasnesër. E dyta, kush do ma bëjë mendimin e kryetarit? Se do bashkohen gjykatat dhe nuk do jetë më kryetari.

(Zoti Toro flet pa ndezur mikrofonin.)

**Brikena Ukperaj:** Alban, shiko sa mirë i bën llogaritë e tua. Për llogaritë tona, – merre për një ditë thotë.

Po nuk bëhet mo Alban.

Po jo, se ka afate ai.

Unë dua dy muaj më thotë ligji, ti thua jo, – bëje për një ditë.

(Zoti Toro flet pa ndezur mikrofonin.)

**Brikena Ukperaj:** Një sekondë! Nuk do vijë asnjë vlerësim në Këshill në qoftë se nuk është kualifikuar. Është shumë e thjeshtë. Por të paktën të bëjmë punën mo Alban, se nuk mundemi dot. Kemi bllokuar me shorte, me çdo gjë.

(Zoti Toro flet pa ndezur mikrofonin.)

**Brikena Ukperaj:** Një sekondë. Pak procedura vlerësimi filluam ne dhe gjyqtarët u shkarkuan nga organet e rivlerësimit? Po ne i kualifikuam. Ne i kualifikuam për kritere ligjore; ne filluam procedura vlerësimi; ata ishin në gradim.

Për kritere ligjore, jo për verifikim të figurës dhe pasurisë Marçela. Flas për kriteret ligjore. Lëvizja paralele flet për kualifikim dhe kualifikim barazon kriteret ligjore, se këtu nuk ka verifikim të pasurisë dhe figurës. Është e thjeshtë.

**Naureda Llagami:** A ka problem të ndërpritet pastaj procedura?

**Brikena Ukperaj:** Nuk ka asnjë problem. Thjesht, të kemi mundësi ta fillojmë.

**Marçela Shehu:** A është bërë më përpara kjo gjë?

Pra a ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar pa kaluar faza...

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, asnjëherë Marçela.

Shiko, ligji nuk thotë në asnjë moment që ti bën vlerësim të detyruar të përshpejtuar vetëm po u kualifikua, as rregullorja nuk e thotë. E futem ne si standard këtë gjë. Tani, në këto kushte, për mua nuk ka asnjë problem. I kualifikojmë dhe fillojmë. Të presim të kualifikohen të katërt dhe t'i fillojmë. Problemi është që, në korrik që ne duam t'i kemi vendet bosh, nuk kemi mundësi t'i kemi sepse, jo se varet nga Komisioni, por ka afate procedure, kanë kryetarët, janë të përfshirë në hartën gjyqësore; dhe menduam që të paktën, në prill, sa nuk është bërë harta, të na vijnë dosjet, të bëjmë shortet dhe pastaj të fillojmë në maj. Unë besoj që në prill karriera (*Komisioni*) patjetër që do t'i sjellë për

verifikim, sepse ju vetëm anën disiplinore dhe përvojën profesionale verifikoni. Kaq.

Kjo ishte Alban. Prandaj edhe në relacion është shpjeguar kjo gjë që është e vërtetë kjo, por kemi vlerësuar kështu.

**Alban Toro:** Krijohet perceptimi.

**Brikena Ukperaj:** Asnjë lloj perceptimi.

**Alban Toro:** (pa mikrofon) Në momentin që unë artikuloj që për ty ka filluar vlerësimi dhe ai lexon që vlerësimi filloka në stadin e dytë të gjësë...

**Brikena Ukperaj:** Nuk mundemi dot që t'i bëjmë vlerësimet më shpejt. Më kupton? Kjo është e gjitha. S'ka rregulla. Këtu s'ka rregulla dhe s'ka kriteret e tjera.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

**Brikena Ukperaj:** Nuk është ndryshim standardi për rregullat e lojës për kandidatin, është ndryshim për sa i përket punës së Këshillit, menaxhim i Këshillit, dhe vlerësimet vazhdojnë... Nuk do vijë asnjë vlerësim në qoftë se nuk kualifikohet. Kjo është shumë e thjeshtë, dhe nuk vjen dot se do tre muaj. Përpiqemi që në korrik t'i sjellim dhe të bëjmë renditjen dhe të plotësojmë vendet. Kjo është, për efekt të punës. Kaq.

Këtu po e deklarojmë, asnjë nga ne në Komision nuk futet... Ajo është për tjetër gjë, sepse ai është thjesht një projekt-akt program për fillim procedure. Ne nuk do sjellim asnjë procedurë të përfunduar pa u kualifikuar kandidati. Kjo s'diskutohet.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në votim projekt-aktin?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, ftojmë administratën për të hedhur shortin.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve kandidatë:

1. {...}, 2. {...}, 3. {...}, 4. {...}.

Futen në enën e dytë të qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve : znj. Brikena Ukperaj (dy shirita); znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa.

Futen në enën e tretë shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin: znj. Gilda Hoxha (dy shirita) dhe znj. Esmerilda Habili (dy shirita).

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Emri i parë i përzgjedhur është z. {...}. Relator për zotën {...} përzgjidhet znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës znj. Gilda Hoxha.

Emri i dytë i përzgjedhur është znj. {...}. Relator për zonjën {...} përzgjidhet znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës znj. Esmerilda Habili.

Emri i tretë i përzgjedhur është z. {...}. Relator për zotën {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës znj. Gilda Hoxha.

Emri i fundit i përzgjedhur është z. {...}. Relator për zotën {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës znj. Esmerilda Habili.

**Naureda Llagami:** Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe

profesional viti kalendarik 2022, për gjyqtarët znj. {...}, z. {...}, z. {...} dhe z. {...}.

2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Brikena Ukperaj – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, kemi shtuar në rendin e ditës edhe një çështje, që ka të bëjë me delegimin e gjyqtarëve në gjykatat në nevojë, kështu që unë do të propozoja që këtë çështje ta kalojmë pak më vonë. Për një ore të mblidhemi për të hedhur shortin “online”.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 28.03.2023)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 15:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                                 |
|---------------------------|---------------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b>2. Irena Plaku</b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>3. Dritan Hallunaj</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>4. Ridvan Hado</b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>5. Alban Toro</b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>6. Marçela Shehu</b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>7. Brikena Ukperaj</b> | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>8. Yllka Rupa</b>      | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.



**Shënim 1:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

**Shënim 2:** Nuk morën pjesë në këtë çështje të rendit të ditës, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami** si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Fatmira Luli**.

\*Çështja filloi në orën 15:00.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Maela Alicanaj, Këshilltare Ligjore pranë Njesisë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.**
- 3. Staf administrativ i KLGJ-së.**
- 4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Mbledhja vijon me çështjen e fundit në rendin e ditës, që lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën zoti Toro për të vijuar me relatimin e të gjitha relacioneve për secilën nga kërkesat e paraqitura nga gjykatat që janë në nevojë.

Fillimisht propozohet radha e procedurave të shortit sipas kësaj radhe:

A. Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.
2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.
3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë
5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

II. Gjykatat e shkallës së parë me juridiksion administrativ

1. Gjykata administrative e shkallës së parë Korçë.

Pasi anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime me radhën e procedurave të shortit, vijohet me relativimin e relacioneve përkatëse.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ajo ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, seksioni penal.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe*

*kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtar z. Lazër Sallaku.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ajo ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë civile (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjeve, në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, konkretisht: Z. Aurel Arapi.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarët z. Aurel Arapi dhe znj. Alda Sadiku.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari z. Aurel Arapi.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** ajo ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, konkretisht: Z. Besnik Shehu.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët znj. Thomaidha Roça dhe z. Ervin Sulaj.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë** ajo ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, 2 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e

gjqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, konkretisht: znj. Olkeda Liçe si dhe znj. Erlanda Agaj, për të cilën do të trajtohet në mbledhje plenare komandimi i saj pranë KLGJ-së.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, civile, (kërkesa 78), gjyqtar z. Rudi Laze.

Për çështjen nr. 2, penale, (kërkesa 76), gjyqtari z. Nertil Dushku.

Për çështjen nr. 1, penale, (kërkesa 77), gjyqtarët z. Rudi Laze dhe z. Nertil Dushku.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet** ajo ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje

gjqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (duke mbajtur në konsideratë afërsinë gjeografike dhe mundësinë e realizimit të shorti si dhe duke mbajtur në konsideratë, gjyqtarët të cilët kanë papajtueshmëri, sipas informacionit të paraqitur në këtë relacion).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3 (ku shkaqet janë të përmendura në relacion).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, konkretisht: z. Enkel Peza, si dhe znj. Vjola Canaj për shkak të ngarkesës.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari znj. Dorina Stroka.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët z. Hektor Sinanaj (relator), z. Laurent Fuçia dhe znj. Dorina Stroka (anëtarë).

Relacioni i fundit lidhet me trajtimin e kërkesë së **Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Korçë**, e cila paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e

një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 (katër) çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti, zëvendëskryetarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë: znj. Elvana Çiçolli.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, (kërkesa nr. 252) gjyqtarja znj. Gentiana Muçaj.

Për çështjen nr. 4, (kërkesa nr. 581) gjyqtarja znj. Afërdita Maho.

Për çështjen nr. 1, (kërkesa nr. 114) gjyqtarja znj. Gentiana Muçaj.

Për çështjen nr. 2, (kërkesa nr. 240) gjyqtarja znj. Afërdita Maho.

Mbyllen procedurat e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**